

VENDIM
Nr.281 datë 1.7.1992

PËR LIBERALIZIMIN DHE RRITJEN E ÇMIMEVE TË BLERJES NGA SHTETI TË DISA
PRODUKTEVE BUJQËSORE E BLEGTORALE

Me propozimin e Misitrisë së Finncave e të Ekonomisë dhe të Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çmimet maksimale të blerjes së grurit, të panxharsheqerit, luledielli dhe orizit caktohen si vijon:

- | | |
|---------------------|-------------|
| - Grurë i butë | 850 lekë/kv |
| - Panxharsheqeri | 110 " " |
| - Luledielli | 1200 " " |
| - Oriz i pazhveshur | 1520 " " |

2. Çmimet e blerjes së mishit, të qumështit, misrit, fasuleve, sojës, duhanit e ullirit liberalizohen dhe caktohen sipas këkresës dhe ofertës në marrëveshje ndërmjet palëve.

3. Gjatë periudhës së korreve, duke filluar nga muaji qershor i këtij viti, grumbullimi i grurit nga fshatarësia do të bëhet gjer më 31 korrik me çmimin 350 lekë/kv. Duke filluar nga data 1 gusht, çmimi i blerjes së grurit të jetë 850 lekë/kv dhe fshatarësisë t'i paguhet diferenca.

4. Për efekte financiare sasia e grurit që do t'i blihet fshatarësisë, të mbahet si rezervë dhe t'u shitet fabrikave të miellit vetëm në një vendim të veçantë të qeverisë. Në raste urgjence, të shkaktuara nga vonesa e furnizimit me grurë nga ndihmat nga jashtë, mund të përdoret kjo rezervë, por me kusht që të zëvendësohet më vonë nga kontiongjentet e ndihmave të huaja ushqimore.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.181, datë 17.6.1991 "Për rritjen e çmimit të blerjes nga shteti të disa produkteve bujqësore e blegtorale dhe subvecionmimin e kooperativave bujqësore malore për bukën", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi